

Akt Themelimi dhe Statuti i Shoqërisë "MAUREA" SH.P.K.
(Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar)

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar ; dhe Ligjin nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Unë i nënshkruari:

Shoqëria Halisof shpk., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në regjistrin tregëtar në QKB me datë 24.06.2011, identifikuar me NUIS L11824011M, me seli në adresën, Lagjja nr. 04, Rruga Fetah Bllaca, Pallati nr. 1133, Zona Kadastrale 8514, Kati trete, përballë shkollës Jusuf Puka, Durrës me Ortak dhe Administrator të vetëm **z. Klaudio RIKO**, lindur me datë 13.02.1979 në Korçë dhe banor në Tiranë, i identifikuar me leternjoftimin me nr personal H90213026L;

Në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar vendos me vullnetin tim të lirë dhe të plotë sa më poshtë vijon:

KAPITULLI I
EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Emërtimi

Sot në datë **12.12.2023** themelimi dhe Emri i Shoqërisë është "**MAUREA**" SH.P.K.

Neni 2 - Selia

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Hamdi Garunja, Nr.Pasurie 102/22+2-N2, ndodhur në Zonën Kadastrale Nr. 3266, Farke, Sauk, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë, filiale, apo zyra përfaqësimi, gjatë aktivitetit të saj, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).


Neni 4 - Objekti i Veprimtarisë

Objekti i Veprimtarisë është:

Investimi me qëllim zhvillimin, ndertimin, administrimin dhe shitjen e objekteve turistike/hoteliere dhe rezidenciale (hotele, apart-hotele, vila, apartamente banimi, ambiente shërbimi, qendra tregtare, ambiente rekreative dhe argetuese, etj.)

Neni 5 – E drejta për të ndryshuar

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, të transferojë selinë e shoqërisë në një vend tjetër, të



ndryshojë objektin e shoqërisë, të rrisë numrin e ortakëve dhe të rrisë kapitalin e shoqërisë, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

KAPITULLI II KAPITALI I SHOQËRISË, SHPËRNDARJA, TRANSFERIMI

Neni 6 - Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 30.000.000 (*tridhjetë milion*) lekë.
- 6.2. Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 1 (një) kuotë, me vlerën prej 30.000.000 (*tridhjetë milion*) lekë.
- 6.3. 1 (një) kuotë, që korrespondon me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë zotërohet nga:
 - **Shoqëria Halisof shpk.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në regjistrin tregëtar në QKB me datë 24.06.2011, identifikuar me NUIS L11824011M, me seli në adresën, Lagjja nr. 04, Rruga Fetah Bllaca, Pallati nr. 1133, Zona Kadastrale 8514, Kati i tretë, përballë shkollës Jusuf Puka, Durrës me Ortak dhe Administrator të vetëm **z. Klaudio RIKO**, lindur në Korce, me datë 13.02.1979 dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftimin me nr personal H90213026L.

Neni 7 - Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 7.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në mënyrë të pakufizuar dhe në çdo moment, një apo disa herë, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.
- 7.2. Shoqëria mund të zvogëlojë gjithashtu kapitalin e shoqërisë me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve. Në çdo rast kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet më shumë se kufiri minimal i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 7.3. Detyrimet e ortakëve kundrejt Shoqërisë janë të kufizuara dhe do të mbulohen vetëm për pjesën e kapitalit të paguar prej tyre. Ortakët nuk do të kenë asnjë përgjegjësi tjetër për detyrime të tjera eventuale të Shoqërisë.

Neni 8 – Transferimi i Kuotave dhe e Drejta e Parablerjes

- 8.1. Të gjitha apo një pjesë e kuotave të kapitalit të shoqërisë mund tu transferohen të tretëve nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.



- 8.2. Në rast të transferimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë me çfarëdolloj titulli tek të tretët, ortakët e tjerë të Shoqërisë janë të preferuar dhe gëzojnë të drejtën e parablerjes së këtyre kuotave, në proporcion me pjesën e kuotave që ato vetë zotërojnë, dhe me të njejtin çmim dhe të njejtat kushte të ofruara nga të tretët.
- 8.3. Në këtë rast, ortaku transferues i kuotave, duhet ti komunikojë ortakëve të tjerë çmimin e ofruar nga të tretët, duke i paraqitur me shkrim këtë ofertë. Ortakët e tjerë të shoqërisë kanë 30 (tridhjetë) ditë kohë, nga marrja e ofertës me shkrim, për ti komunikuar ortakut transferues dhe ortakëve të tjerë, dëshirën e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Përsa kohë ortakët e tjerë të shoqërisë nuk përgjigjen brenda afatit të përcaktuar, e drejta e parablerjes në favor të tyre presumohet e refuzuar.
- 8.4. Nëse njëri prej ortakëve, të cilëve i është ofruar mundësia për të parablerë në proporcion me pjesën e tij, kuotat e ortakut transferues, nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, ortakët e tjerë që e kanë ushtruar për pjesën e tyre të drejtën e parablerjes, mund ta shtrijnë këtë të drejtë edhe mbi të gjitha ose një pjesë të kuotave të cilat i janë ofruara ortakut, dhe që ky i fundit nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.
- 8.5. Në rast se më shumë se një ortak dëshiron të shtrijë të drejtën e parablerjes, mbi kuotat e ofruara ortakut që nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, këto kuota do të ndahen në mënyrë të barabartë.
- 8.6. Në rast se vetëm një ortak dëshiron të shtrijë të drejtën e parablerjes, mbi kuotat e ofruara ortakut që nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, këto kuota do të transferohen këtij ortaku të gjitha, ose vetëm për atë pjesë kuotash që ai do të dëshirojë të parablejë.
- 8.7. Për këtë qëllim, ortakët e interesuar për të shtrirë të drejtën e tyre të parablerjes, duhet të njoftojnë me shkrim ortakun transferues, mbi vendimin e tyre brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për refuzimin e ushtrimit të të drejtës së parablerjes nga cdonjëri prej ortakëve.
- 8.8. Të gjitha komunikimet e lartpërmendura duhet të behën në formë të shkruar.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORI, KONTROLLI

Neni 9 – Asambleja e Ortakëve

- 9.1. Organi vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e ortakëve.
- 9.2. Vendimet e marra me shumicë nga Asambleja e ortakëve janë të vlefshëm dhe të detyrueshëm për ortakët të cilët mungojnë apo nuk dëshirojnë të marrin pjesë, përveç rasteve dhe të drejtës së tyre për të kundërshtuar këto vendime, në rastet dhe format e parashikuara nga dispozitat ligjore.

Neni 10 – E Drejta e Pjesëmarrjes dhe e Drejta e Votës

- 10.1. Seicili prej ortakëve ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij, si dhe të shprehet me votë sipas kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin e shoqërisë.
- 10.2. Çdonjëri prej ortakëve ka të drejtë të përfaqësohet në Asamble nga një i deleguari i tij, me anë të një prokure apo autorizimi me shkrim, i cili mund të votojë gjithashtu në emër të ortakut.
- 10.3. Çdonjëri prej ortakëve nuk mund të lëshojë prokurë apo autorizim për të votuar për një pjesë të kuotave të kapitalit të zotëruar prej tij, nëse voton personalisht vetë për pjesën tjetër të kuotave të mbetura të kapitalit.

Neni 11 - Mbledhja e Asamblesë

- 11.1. Asambleja e zakonshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, si dhe brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e ushtrimit dhe miratimit të bilancit.
- 11.2. Asambleja mund të thirret në çdo kohë nga një apo më shumë ortakë që përfaqësojnë 5% (pesëpërqind) të kapitalit të shoqërisë. Asambleja mund të thirret gjithashtu në çdo kohë nga Administratori, nga eksperti kontabël, apo nga likuiduesi i shoqërisë.
- 11.3. Mbledhja e Asamblese duhet të mbahet në selinë e shoqërisë ose në ndonjë vend tjetër të vendosur paraprakisht me vendim unanim të ortakëve të shoqërisë.
- 11.4. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, i cili duhet tu dërgohet ortakëve në adresën ku banojnë apo punojnë, ashtu sic është e përcaktuar tek Libri i Ortakëve, ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 11.5. Kur Asambleja nuk është thirrur sipas rregullave dhe procedurave të lartpërmendura, ajo mund të konsiderohet e mbledhur rregullisht dhe të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 11.6. Asambleja e zakonshme vendos dhe është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, mbi të gjitha çështjet të cilat nuk janë kompetencë ekskluzive e Asamblesë së jashtëzakonshme, dhe në mënyrë të vecantë vendos për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - c) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - f) Shpërndarjen e fitimit;
 - g) Etj.



- 11.7. Asambleja e zakonshme do të konsiderohet rregullisht e mbledhur dhe mund të marrë vendime të vlefshme, në rast se në të marrin pjesë ortakët apo përfaqësuesit e tyre, të cilët përfaqësojnë të paktën 30% (tridhjetë përqind) e kapitalit të shoqërisë.
- 11.8. Asambleja e jashtëzakonshme do të konsiderohet rregullisht e mbledhur në rast se në të marrin pjesë ortakët apo përfaqësuesit e tyre, të cilët përfaqësojnë të paktën 3/4 (tre të katrat) e kapitalit të shoqërisë, si dhe mund të marrë vendime të vlefshme, në rast se votojnë në favor të një cështje ortakët apo përfaqësuesit e tyre, të cilët përfaqësojnë të paktën 3/4 (tre të katrat) e kapitalit të shoqërisë.
- 11.9. Asambleja e jashtëzakonshme vendos mbi:
- a) ndryshimet e Statutit;
 - b) themelimin e filialëve, degëve apo zyrave të përfaqësimit;
 - c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - d) transferimin e kuotave të kapitali të shoqërisë;
 - e) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve;
- 11.10. Çdo Asamble drejtohet nga një ortak apo person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për mbajtjen e procesverbalit Asambleja cakton gjithashtu një Sekretar.
- 11.11. Vendimet e Asamblesë duhet të hidhen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga Drejtuesi i Asamblesë dhe Sekretari i saj. Në procesverbal duhet të mbahen në mënyrë të përmbledhur edhe deklaratimet e ortakeve, nëse kjo gjë kërkohet prej tyre.

Neni 12 – Administrimi

- 12.1. Asambleja e zakonshme e Shoqërisë ka të drejtën të emërojë një apo më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë.
- 12.2. Administratorët e Shoqërisë emërohen në detyrë për një afat kohor maksimal prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë riemërimi. Gjithësesi, emërimi në detyrë i administratorëve për një afat kohor më të shkurtër përcaktohet me vendim të Asamblesë së zakonshme të Shoqërisë.
- 12.3. Administratorët e Shoqërisë kanë të gjitha kompetencat dhe fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të punëve të cilat janë pjesë e objektit të shoqërisë, duke përfshirë këtu të drejtën e delegimit të kompetencave dhe fuqive përfaqësuesve të tjerë të posacëm, me përjashtim të atyre kompetencave dhe fuqive të cilat legjislacioni dhe Statuti i Shoqërisë ia rezervojnë në mënyrë eksklusive Asamblesë së ortakeve.
- 12.4. Administrator i Vetëm i Shoqërisë është: **znj. Monila Karaj**, lindur ne Tirane, me date 12.02.1989 dhe banues ne Tirane, i identifikuar me leternjoftimin me nr personal I95212076G



- 12.5. Asambleja e ortakëve mund të shkarkojë në çdo kohë dhe me shumicë të thjeshtë Administratorin/ët e shoqërisë. Si Statuti, ashtu edhe çdo marrëveshje tjetër e mëvonshme, nuk mund të parjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë të përcaktuar në mënyrë të qartë nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 13 - Ekspertët dhe Revizorët Kontabël

- 13.1. Nëse është e nevojshme apo nëse kërkohet nga legjislacioni, kontrolli mbi veprimtarinë financiare të shoqërisë, si dhe mbi të gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një apo më shumë ekspertëve ose revizorëve kontabël të autorizuar, të cilët emërohen sipas procedurave të parshikuara nga dispozitat ligjore në fuqi dhe Statuti i Shoqërisë, me të drejtë riemërimi.
- 13.2. Shkarkimi i ekspertëve ose revizorëve kontabël të autorizuar bëhet në të njejtën mënyrë dhe duke ndjekur të njejtat procedura me atë të emërimit të tyre.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 14 - Viti financiar dhe Bilanci Vjetor

- 14.1. Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin, të cilat miratohen nga Asambleja e ortakëve, me votat e ortakëve apo përfaqësuesve të tyre, të cilat përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

Neni 15 - Shpërndarja e fitimeve

- 15.1. Fitimet neto, të cilat rezultojnë nga bilancit vjetor i Shoqërisë, pasi të hiqen 5% (pesë përqind) të cilat destinohen për tek rezerva ligjore deri në përmbushjen e 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, si edhe pasi të mbahen shuma të tjera të nevojshme bazuar në vendimin e Asamblesë së ortakëve, pjesa e mbetur i shpërndahen ortakëve të shoqërisë në proporcion me kuotat e zotëruara prej tyre të kapitalit të shoqërisë.
- 15.2. Asambleja e ortakëve mund të vendosë kalimin e shumave të tjera nga fitimi neto, dhe destinimin e tyre, për rezerva të jashtëzakonshme të shoqërisë, apo për qëllime të tjera, përfshirë këtu mundësinë e shtyerjes së shpërndarjes së fitimeve - për të gjithë apo për një pjesë të saj – në vitet pasardhëse, apo për përmbushjen e shërbimeve të tjera të Shoqërisë.



KAPITULLI V
PRISHJA (SHPËRNDARJA) DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË
Neni 16 – Prishja (Shpërndarja) e Shoqërisë

- 16.1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet kur mbaron afati i kohëzgjatjes së parashikuar në Aktin e Themelimit të saj, ose përpara këtij afati, në rastet e parshikuara nga legjislacioni në fuqi, ose me vendim të Asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve.
- 16.2. Shoqëria nuk prishet në rastet e paaftësisë, vdekjes apo falimentimit të ortakëve.

Neni 17 - Likuidimi i Shoqërisë

- 17.1. Në rast të prishjes (*shpërndarjes*) për çdo lloj arsye, Shoqëria do të fillojë procedurat e likuidimit.
- 17.2. Më qëllim nisjen e procedurave likuiduese, Asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve, përcakton mënyrën e likuidimit, dhe emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët do të përgatisin të gjitha dokumentet e nevojshme për të përfunduar likuidimin e Shoqërisë, si dhe c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Neni 18 - Dispozita të Përgjithshme

Përsa është shprehur në këtë Statut i referohemi Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar ; Ligjit nr. 9723. datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar ; dhe Ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Çdo ndryshim bëhet në përputhje me këtë Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj Shoqërie.

Neni 19 - Gjuha

Ky Statut është hartuar dhe firmosur në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin përsa i përket interpretimit të këtij Statuti, versioni në gjuhën shqipe do të jetë i vetmi ligjërishit i vlefshëm.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
“Halisof” SH.P.K.

PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI

z. Klaudio RIKO

KLAUDIO RIKO

